



PROCESVERBAL 22/2022

I mbajtur me rastin e takimit të 2 (dytë) për vitin 2022 të Komunitetit për Komunitete, mbajtur me datë 22.02.2022 duke filluar nga ora 9:00.

Rend dite

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;
3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;
4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko - Regjoni” Sh.A;
5. Shqyrtimi projekt - vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave;
6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754;
7. Të ndryshme;

Takimin e hapi Kryesuesi Denis Sofra dhe i njoftoi me rendin e ditës.

Kryesuesi - a pajtoheni me rendin e ditës?

Aprovohet

Pika 1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi - a pajtoheni me procesverbalin?

Aprovohet.

Pika 2. Shqyrtimi i projekt - vendimit për miratimin e kërkesës të punëtorëve të Administratës së Komunës;

Kryesuesi - i njofton me pikën.

Avni Bytyqi - përshëndet të pranishmit. Mandatin e kaluar e kemi marrë një vendim të tillë, por është kthye në rishqyrtim pasi nuk ka qenë e planifikuar në buxhet. Ne për vitin 2022 e kemi planifikua pagesën e shujtës për punëtorët e administratës, dhe ka ardhë një kërkesë nga punëtorët e administratës që të rritet vlera e shujtës në 3.5 euro.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 3. Shqyrtimi i projekt-vendimit për themelimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për bursa;

Kryesuesi - i njofton me pikën.

Avni Bytyqi - sipas rregullores për ndarjen e bursave e kemi obligim që ta themelojmë një komision nga Asambleja që ti shqyrtojë kërkesat që vinë ndaj aplikacioneve që janë të pakënaqur nxënësit apo studentat .Në Asamble do të propozohen emrat.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 4. Shqyrtimi i projekt - vendimit për themelimin e komisionit komunal të aksionarëve të Ndërmarrjes Publike Lokale “Eko - Regjioni” Sh.A;

Avni Bytyqi - në Ndërmarrjen Publike Lokale “Eko Regjioni” ,Komuna jonë është aksionare me rreth 13 %,dhe e kemi obligim që ta themelojmë këtë komision. Komisioni do ti ketë tre anëtar.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 5. Shqyrtimi projekt - vendimit për formimin e komisionit për zgjedhjen e Drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të shkollave;

Avni Bytyqi - është kërkesë e drejtorisë së arsimit që të themelohet ky komision,pasi do të kemi konkurse për disa shkolla, ku iu ka kalu mandati disa drejtorëve të shkollave. Dy të propozuarit janë nga drejtoria e arsimit dhe një nga ministria,kurse dy përfaqësues,një nga këshilli i prindërve dhe një nga këshilli i mësimdhënësve do të jenë në cilësinë e vëzhgueseve.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 6. Shqyrtimi i projekt-vendimit për shfuqizimin e vendimit 01-Nr-016-61754;

Avni Bytyqi - në vitin 2022 është marrë vendimi për subvencionimin e qytetarëve me Covid. Mirëpo Komuna e ka të vështirë ta përballojë dhe jemi të detyruar ta ndërpremë këtë subvencionim.

Kryesuesi - a pajtoheni?

Aprovohet

Pika 7. Të ndryshme;

Nazim Shabanaj - në fashatin Gelancë,në mëhallën e Nurës, ka 25 ditë që kjo lagje nuk ka ndriçim në rrugë. Të gjitha lagjet tjera kanë drita.

Takimi përfundoi: 09:12